



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) - Rahovec, e mbajtur më 07.08.2023, me fillim në ora 15:00. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunal zt. Smajl Latifi. Për mbajtjen e mbledhjes kuorumi ekziston, shumica e anëtarëve janë të pranishëm.

Kryetari - Më lejoni t'i përshëndes anëtarët e KKSBB-së, përshëndes nënkryetarin e komunës zt. Fatmir Iska, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, zt. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit FSK-së, OSBE-së, KFOR-it, LMT-së dhe mediat. Është mbledhja e katërt e rregullt për vitin 2023. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Siguria në trafik;
 - Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës nga personat e papërgjegjshëm;
 - Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesit;
 - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror;
 - Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
3. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër – fetar;
4. Të ndryshme.

Kryetari – Atëherë, a ka dikush ndonjë koment rreth rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për?... Kundër?... Abstenim?... Konstatojmë që rendi i ditës është miratuar me shumicë votash.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryetari – A ka dikush ndonjë koment ose vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Me shumicë të votave, miratohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;

Kryetari – Për detaje do ta marrë fjalën komandanti i stacionit zt. Fazli Morina, por mund të konstatojmë që situata e sigurisë ndërmjet dy takimeve, ka vazhduar të jetë e qetë, e mirë dhe stabile. I kemi edhe nënpikat e pikës së dytë për të cilat do të flasim në vazhdim. Në Komunën e Rahovecit në bazë të argumenteve dhe burimeve që i posedojmë është stabile, e qetë dhe pa ndonjë ndryshim të theksuar nga takimi i fundit i mbledhjes së KKSBB-së, ani pse gjatë këtij muaji ka pasur në vazhdimësi zhvillime duke e karakterizuar muajin e ardhjes së bashkatdhetarëve.

Fazli Morina – I nderuar kryetar! Të nderuar anëtarë të KKSBB-së, përshëndetje për të gjithë. Ka pasur shumë aktivitete, shumë plane operative dhe shumë angazhime. Gjendja në komunën tonë është e qetë dhe stabile, duke mos përfshirë rastet e veprave në trafik dhe të tjera. Urdhër operativ kanë qenë gjithsej 13, 7 plane operative, 13 plane të veprimit dhe 3 projekte (gjuajtja me armë në ahengje, siguria në trafik dhe dukuria e zjarreve). Vizitë

pelegrinësh kanë qenë 4 me 425 vizitorë në komunën tonë. Para stacionit tonë kanë qenë të inicuar 94 vepra penale dhe 2 incidente jopenale. Lëndime të rënda 3 raste, lëndime të lehta 9 raste, vjedhje 13, vjedhje të rënda 14, dhunë në familje 6 raste, armëmbajtje pa leje, 3 raste (4 armë të konfiskuara). Gjatë kësaj periudhe kanë qenë 36 persona të arrestuar, persona të ndaluar në mbajtje 24, realizim të urdhëresave 39. Siguria në shkollë ka qenë e mirë dhe vazhdohet me implementim të planeve tona. Gjithsej kanë qenë vetëm 2 raste. 51 vizita në shkollë, patrullime 342 dhe 9 pika kontrolli rreth shkollave. Sa i përket sigurisë në komunikacion, është jo situatë e mirë për shkak të fluksit të madh të makinave. Janë shqiptuar 1071 gjoba në trafik, 59 prej tyre janë pa patent-shofer, 8 gjoba në masë të ndalimit të drejtimit të automjetit, 329 gjoba për parking të palejuar, 14 për përdorim të telefonit dhe 14 prishje të rendit dhe qetësisë publike. Kemi një numër të madh të aksidenteve, vetëm nga stacioni jonë janë të inicuar 18 raste me dëme materiale, ndërsa në rastet tjera që është marrë njësia e trafikut rajonal në Gjakovë, janë gjithsej 54 raste të aksidenteve, prej tyre 1 rast është me fatalitet, 37 me lëndime trupore, 88 persona të lënduar dhe 16 raste tjera me dëme materiale.

Fadil Sylka - Përshëndetje për të gjithë! E kam një pyetje për komandantin, për shpërndarësit e picave dhe të hamburgerëve (fast food) me motoçikleta, janë në shumicën e rasteve fëmijë të mitur dhe pa masa mbrojtëse. Është e domosdoshme që ata të kenë masa mbrojtëse (kapelë) dhe të kenë patent-shofer.

Fazli Morina – Faleminderit Fadil, një pyetje shumë me vend. Kjo situatë situatë qëndron jo vetëm me shpërndarësit e picave, por edhe me vozitësa tjerë në qytet. Falë angazhimit tonë me aq sa kemi mundësi, po e bëjmë punën tonë. Është problem i përgjithshëm. Faji fillon prej familjarëve që ia kanë dhënë atë motoçikletë, faj ka edhe punëdhënësi që e angazhon në punë një fëmijë nënmoshë dhe pa patent-shofer.

Kryetari – Faleminderit komandant! E vërtetë që ka prishje të rendit dhe qetësisë publike gjatë natës dhe është shumë e vështirë të parandalohen, sepse ahengjet po bëhen edhe në mjedise familjare edhe pas orës 24. Sa i përket lëmoshëkërkesëve në qytet, janë disa prej tyre sidomos rreth kafiterive të palestra vazhdimisht sillen. Poashtu ka vozitës pa patent-shofer të motoçikletave, siç ka edhe të mitur që nuk kanë të drejtë pune, përkundër asaj, ata punojnë sepse mungon fuqia punëtore. Policia ka plane operative të ndryshme për t'i menaxhuar këto situata sfiduese. Duke u bazuar në fluksin e madh që ka ndodhur këto muaj, p.sh. në koncertet të palestra sportive dhe organizimet tjera si Agro-Festa, nuk kemi pasur ndonjë situatë problematike ose ndonjë incident. Sa i përket sigurisë në trafik, ndoshta ka edhe mungesë të patrullimeve nga ana e policisë, për shkak të personelit të pamjaftueshëm. Sa i përket mungesës së çmimeve në produkt, inspektoriati ynë ka shqiptuar disa gjoba, sepse në këtë rast produkteve ushqimore iu kanë munguar çmimet. Problemet me ujë të pijshëm, sivjet janë më të mëdha sesa në 5/6 vitet e fundit. E kemi një situatë paradoksale, liqeni është plot me ujë, kemi vazhdimisht ndërrim të gypave të azbestit dhe humbjet e ujit besoj që llogariten që shkojnë duke u zvogëluar dhe të ketë furnizim të rregullt, por ka ndodhur e kundërta. Ne jemi shumë të pakënaqur me menaxhimin jo të mirë nga udhëheqja e KRU-Gjakovës. Është e vërtetë që ka keqpërdorime të mëdha të ujit dhe konsiderohet që kjo gjendje ka shkaktuar probleme. Për të qenë në shërbim të qytetarëve, kemi marrë përsipër punët të cilat nuk na takojnë neve si komunë dhe për zbulimin e keqpërdoruesëve ia kemi ofruar inspektoriatin tonë në terren. Ndoshta kjo ka ndikuar që ta kemi një situatë më normale dhe më pozitive në furnizimin e ujit të pijshëm. Nuk është qasje e mirë e menaxhmentit të ri të KRU – Gjakovës dhe jam i gatshëm t'i bëj presion për punë të mira, sepse na duhet një menaxhment i përgjegjshëm.

3. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër – fetar;


Kryetari – Besoj që komuna jonë vazhdon të jetë shembull i mirë i stabilitetit dhe bashkëjetesës edhe pse është komunë multikulturore dhe multifetare. Këtë që po e them është në dijeni edhe OSBE-ja, LMT-ja dhe të gjithë ata që e kanë për detyrë që ta përcjellin situatën e sigurisë dhe të diversitetit kulturor ndër-etnik. Nëse dikush ka diçka për të thënë në lidhje me këtë temë, mund ta merrë fjalën!

Po e bëj edhe një apel në emër të Besmires, përkundër vapës së madhe muajve të fundit, nuk kemi pasur shumë zjarre të shkaktuara. Deri sot jemi të kënaqur, sepse deri më tani nuk kemi pasur një situatë sfiduese. Gjithashtu kemi një ndërgjegjësim të madh të qytetarëve të komunës sonë rreth asaj se pse nuk duhet të ndezim zjarre pa nevojë, njëkohësisht nuk ka nevojë t'i angazhojnë zjarrfikësit dhe qytetarët vullnetarë për fikje.

4. Të ndryshme;

Kryetari – Nga mbledhja e ardhshme, kuvendi i komunës ka vendosur rreth ndryshimit të anëtarëve të KKSB-së. Ka ndodhur një ndërrim në “Shoqatën e Bizneseve” dhe në vend të Fadil Sylkës nga mbledhja e ardhshme do të jetë, Mustafë Korenica. Fadilin e falënderoj për kontributin e deritashëm. Nëse jemi të pajtimit, po e mbyllim këtë takim. Faleminderit secilit veç e veç. Mirupafshim në takimin e radhës.

Procesmbajtësi



Albion Krasniqi

Kryetari i Komunës

Smajl Latifi

